

KËRKIME GJUHËSORE

Valbona KALEMI

GJURMË TË NDIKIMIT TË MJETEVE TEKNOLOGJIKE NË KOMUNIKIMIN ME SHKRIM E ME GOJË NËSHQIPEN E SOTME

Abstract. Today in the Albanian space the new means of mass communication have taken great spreading. The majority of the active generations today are served, not only by the means of the fixed telephone, but also the mobile one which extend increasingly their influence in the scopes of the internet by the means of e-mails, system of chatting, and the visual ones, such as Skype.

A new scope of research which is worthy to be mentioned is the communication among young people by the means of messages in internet and mobile phone by so creating a new scope of sociolinguistic research.

The youth discourse has a tendency for *abbreviation-reduction* in the everyday communication by the means of the mean which is becoming a new special area of study in the Albanian space in these 20 years, unstudied in the past before our involvement in *globalism* as a result of the development of the technology.

Sot në hapësirën shqiptare ka marrë përmasa të mëdha edhe një shtrirje të gjerë mjetet e reja të komunikimit masiv. Shumica e brezave aktive sot shërbehen, jo vetëm nga telefonia fikse, por edhe nga ajo e lëvizshme (celular) të cilat shtrijnë ndikimin përherë e më shumë në hapësirat e internetit me anë të e-mail-eve, sistemit të chatimeve në të shkruar si dhe në ato pamore, skype-s.

Një hapësirë të re hulumtimi vlen të përmendim komunikimin midis të rinjve me njeri-tjetrin me anë të mesazheve në internet dhe celular duke u krijuar madje edhe një fushë të re hulumtimi sociolinguistik.

Ligjërimi rinor ka një prirje për *shkurti e shkurtesa* në komunikimin e përditshëm bisedor me anë të mjetit gjë që bëhet një fushë e re studimore e veçantë në hapësirën shqiptare në këto 20 vjet e pa studiuar më parë para përfshirjes në *globalizëm* si rezultat i zhvillimit të teknologjisë.

Duke vënë re gjithnjë e më tepër ndikimin e përdorimeve të pamira në gjuhën shqipe sidomos pakujdesinë ndaj rregullave të gramatikës e të drejtshkrimit duke sjellë dëmtime të rënda në “kulturën e gjuhës shqipe” të cilat i shohim sot, kurse dje nuk ishin shfaqur nga “flukset e dukshme” të quajtura nga sociolinguistika e sotme.

1. Gjuha shqipe, falë teknologjisë së re në internet ose në mesazhe celularësh e përdorur nga të rinjtë karakterizohet nga synimi për “shkurti e shpejtësi kumtuese” e cila është e përfillshme në kohët ku jetojmë, por po shihen elemente të një “ligjërimit të fshehur” duke vërsuar forma të parregullta, si një veçori e një grupi shoqëror sidomos e atyre rinor.

2. Krahas formave të shkurtuara që ne njohim dhe përdorim duke patur edhe fjalorët e tyre shpjegues, këto forma të veçanta që kanë lindur nuk kanë fjalor shpjegues sidomos masa më e madhe e tyre.

3. Hapësirat e reja që janë krijuar sot shpërfaqin variabilitete dhe sjellje gjuhësore që janë të lidhur me tregues moshorë, krahinorë, kulturorë etj.

4. “Mosha” si një faktor jashtëgjuhësor e përfillur në rrethet sociolinguistike, është vënë re për rolin e ndryshueshmërisë gjuhësore si një aspekt “i dinamikës” dhe i “rinisë” që në rastin tonë u atribuohet brezit të ri, studentëve si brezi më aktiv i shoqërisë. Duke parë dy mosha të rinj e jo të rinj gjuhëtarët me të drejtë kanë shtruar pyetje për veçantinë e të folurit rinor dhe për ndryshueshmërinë e gjuhës.

5. Tashmë e dimë se para se individ të fitojë një kompetencë mirëfilli gjuhësore individët sipas moshës u atribuohet një kompetencë komunikative e mbështetur në mundësinë e komunikimit nëpërmjet kanaleve dhe mënyrave joverbale. Nëpërmjet komunikimit joverbal dhe atij të folur (verbal modelit që fëmijët përdorin për të komunikuar vijnë e pranëvihen (komunikimit gjuhësor¹).

6. Në kontekstet joformale në komunikim brenda grupit të cilët trajtojnë argument që u përkasin:

1. Moshës

2. Dashurisë, shkollës, muzikës e seksit

I foluri rinor është konsideruar si një varietet diastratik² e diafizik³.

E rëndësishme është që në një komunikim të zbërthehet përmbajtja – pra ka rëndësi njohja e kodit prej të rinjve në një bisedë që zhvillojnë.

–“Duke e parë që njeriu e pasuron gjuhën me njësi të reja që i krijojnë të tjerët apo ai vetë”⁴. Po kështu me anë të mjeteve gjuhësore që zotëron ai mund të krijojë kombinime të reja duke qenë se gjuha është kreative⁵.

Ky kreativitet i gjuhës duhet sepse gjuha u referohet edhe situatave të reja që krijohen – pa e ndalur zhvillimin e mendësisë së shoqërisë dhe kjo duhet.

–Ky zhvillim mendësie njerëzit kanë realizuar nëpërmjet mjetit elektronik nëpërmjet peshës elektronike.

–Për më tepër shohim edhe raportin e gjuhës së folur dhe asaj të shkruar.

–Sot sjellja njerëzore e “Instrumentalizuar” dhe sidomos komunikimi në veçanti, këto qëndrime të reja janë hapur udhë të reja në mënyrë globale⁶.

Teknologjia shërben tek individët dhe atje shohim modele dhe përkatësi individësh që komunikojnë me të njëjtin kod.

Përdorimi i teknologjisë nga autorë të huaj me të drejtë është quajtur edhe “teknologji intelektuale” duke parë që përmasa shoqërore njeh tri aspekte:

1. Zhvillimin e ekonomisë

2. Zhvillimi i veprimtarisë së individit

¹ Shih Gj. Shkurta, *Etnografi e të folurit*.

² Diastatik – I lidhur me moshën e folësve (në rastin tonë të rinj).

³ Shih Alfonzeti *Sociolinguistika e sotme e shqipe*, f. 236, 2001-2002.

⁴ Shih R. Memushaj, *Hyrje në Gjuhësi*.

⁵ Shih më gjerë R. Memushaj *Hyrje në Gjuhësi*.

⁶ Shih D. Peraja, *Hyrje në teoritë e komunikimit*, f. 365.

GJURMË TË NDIKIMIT TË MJETEVE TEKNOLOGJIKE NË
KOMUNIKIMIN ME SHKRIM E ME GOJË NËSHQIPEN E SOTME

3. Shkalla e kulturimit e cila, pra shkalla e kulturës⁷ me të drejtë shihet si një aspekt kryesor.

-Ky kundrim i gjuhësorës dhe shoqërores vlen për t'u parë si rezultat i flukseve të "padukshme" në rritje në kohët që po kalojmë.

1. "Flukset e dukshme" dhe të "padukshme"

Sot komunikimi gjuhësor në "globalizëm" si një dukuri në rritjen me shpejtësi të madhe të anglishtes si një gjuhë informacioni ndërkombëtar dhe e detyrueshme për t'u mësuar me peshë të madhe dhe fuqizimi i flukseve të padukshme siç është internet dhe komunikimi "online".

a. -Hapja e Shqipërisë ndaj ekonomisë së tregut, zhvillimi i madh i teknologjisë informative kanë krijuar hapësira të reja dhe përparime cilësore të dallueshme.

b. -"Globalizimin" nuk mund ta shohim vetëm në shtrirjen e anglishtes si gjuhë ndërkombëtare, por edhe në prirjen e përhapjes së huazimeve nga gjuhë të tjera në fjalë shërbyese në sfera të ndryshme por edhe fjali të ndikuara nga teknologjia.

c. -Me "rrezik shihet" gërryerja e gjuhëve të popujve të vegjël sidomos edhe në rastin e shqipes ku përdoruesit përdorin forma të pamira duke u bërë më "trendy" modern në komunikimin me njeri-tjetrin.

d. -Brezat aktivë të shoqërisë e keqpërdorin gjuhën shqipe si të duan me se të duan, sot ata shërbehen nga telefonja e lëvizshme (celular) "korrin" përherë hapësira të reja dhe në internet në facebook, me anë të e-mail-eve si dhe në atë pamore "skype-s".

e. Individët, pra të rinjtë bëhen pjesë e ndodhive gjuhësore si përfaqësues të një grupi të caktuar shoqëror.

f. Ky fuqizim i flukseve të "padukshme" të mbishtuara atyre "të dukshme" përveç anëve pozitive shihen nga gjuhëtarët edhe si një ndikim në përdorimin e keq të të rinjve nga ana e tyre si një armik i "zhvillim kufizimit" të kulturës së gjuhës.⁸

Përveç avantazheve që kemi në lehtësinë e komunikimit vihen re deformime drejtshkrimore.

-Përvojat njerëzore ndryshojnë; ato rriten, brezat shërbehen nga teknologjia e kohës si rezultat edhe i mendësisë.

ROLI I INTERNETIT

Duke qenë se mjeti më i sofistikuar për mbartjen e shpejtë të informacionit dhe korrespondencës, internet është bërë mjet i pashmangshëm i veprimtarisë së njerëzve, ndërsa përhapja dhe shtrirja e tij në rrafshin global ka ndikuar në integrimin e hapësirave komunikuese botërore dhe si rrjedhim ka bërë që kontaktet ndërmjet gjuhëve të shtohen. Gjuha shqipe është bërë pjesë e kësaj dukurie.

⁷ Për më gjerë Gj. Shkurtaç, *Etnografia e të folurit të shqipes*.

⁸ Shih Gj. Shkurtaç, *Kultura e Gjuhës*.

Krahas revolucionit që ka shkaktuar në informim interneti ka nxitur edhe ndryshime domethënëse strukturore në gjuhë, duke krijuar një “hapësirë të re virtuale”, në të cilën është pasqyruar variacioni gjuhësor i botës reale.

“Ky ndikim shkon edhe më tej në krijimin e formave të reja komunikative të cilat nuk janë të pranishme në botën reale” shprehet Shkumbin Munishi në artikullin “Gjuha shqipe dhe interneti”⁹. Po cilat janë hapësirat e shqipes në internet dhe cili është ndikimi i tij mbi gjuhën shqipe?

Sipas studiuesit Munishi dëshmohej se shqipja ka zënë vendin e saj në internet., si psh. Google ka futur mundësinë e përkthimeve elektronike për gjuhën shqipe etj. Çdo ditë po krijohen mundësi të reja dhe lehtësira për përdorimin e shqipes

-Veprimtaritë janë të larmishme, nga chat-et (bisedat) e-mail (postë elektronike), Skype e deri tek mesazhet e çastit.

-Interneti ka ndikuar edhe në shfaqjen e varianteve të reja gjeografike e shoqërore të shqipes. Përveç formës standarde që del në faqet zyrtare në veprimtaritë e tjera shfaqen në trajtë të shkruar të folmet e përditshme dialektore, krahinore të cilat japin variantet e shqipes.

-Sot ka ardhur koha të tregohemi kritikë ndaj atyre që e keqpërdorin gjuhën që janë të papërgjegjshëm në pakujdesinë ndaj trajtave e normave standarde të gjuhës.

Cilat janë disa tipare të komunikimit në internet, pra nëpërmjet mjetit.

-Gjuha shqipe në internet ose në mesazhe në celular karakterizohet nga synimi për “shkurti” dhe “shpejtësi kumtuese”, pra që përbën një lloj “ligjërimi të fshehur” krahas fjalëve që ne njohim sidomos tek brezi i ri si krahas pseudonimeve që njiheshin dhe kthimi i fjalëve mbrapsht, fjali banale, perifrazat e figurshme për profesorët, metaforat që i përdornim deri dje për të ironizuar profilet, në një mënyrë figurative ato shpreheshin për notat e marra në shtrembërimet e fjalëve, kalime kuptimore të çuditshme.

-Përdorimi i prapashësive.

Kjo larmi ka qenë e përhapur tek studentët që komunikimin deri dje e kryenin në kontakte fizike, kurse sot është bërë “trendy” e kohës modern komunikimi virtual nën ndikimin e mjetit.

-Në pohimin e profesor Valter Memishës për emërtimet e shkruara në jemi njohur me realitete gjuhësore, sidomos në gjuhën e shkruar dhe shpesh flitet për to edhe si realitete leksikografike¹⁰.

Duke parë veçoritë e çdo gjuhe që kanë një prirje për të krijuar emërtime të shkurtuara sot edhe në Shqipëri këto shtohen me shpejtësi të madhe.

⁹ Shih Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë 1988. Kohë dhe dukuri të kulturës së gjuhës. Kristalina KH, Tiranë 2003. *Kultura e gjuhës*, ShBLU, Tiranë 2006.

Shih Sh. Munishi, *Gjuha shqipe dhe internet*.

¹⁰ Për më gjerë shih V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, f. 199 Qendra e Studimeve Albanologjike. *Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe* 2006.

GJURMË TË NDIKIMIT TË MJETEVE TEKNOLOGJIKE NË KOMUNIKIMIN ME SHKRIM E ME GOJË NËSHQIPEN E SOTME

-Interesante bëhet ky vëzhgim tek të rinjtë të cilët realizojnë komunikimin duke na sjellë një problem në drejtshkrimin e shqipes nga ana e tyre¹¹.

-Pra po të shohim përdorimet në bisedat kur të rinjtë chat-ojnë janë një lloj i veçantë komunikimi në shkrimin që organizojnë këto forma të shkruara të papara e pa pasur fjalor shpjegues.

Ndikime nga interneti dhe kompjuteri.

- Përdorimi i teknologjisë në anglisht krijimi dhe shndërrimi i fjalëve dhe frazave të reja nga ana kuptimore këtë gjë studentët e bëjnë si më të talentuarit.

- Ja ç' thonë studentët¹² “Nuk konsiderohesh komunikues nëse nuk përdor këtë lloj gjuhe, prandaj kjo formë e bisedave në mes njeri-tjetrit tek të rinjtë bëhet edhe e imponuar, nëse nuk praktikohen nuk mund të jesh “modern”. Institucionet si shkolla, burgjet, repartet ushtarake janë mjedise ku lindin kushtet për një gjuhë të re.

Kjo terminologji nga mjeti shpërfaqet në këtë mënyrë.

1. Tek kjo foto ke dalë shumë *like* (Fjalën anglisht e pëlqej e shoqërojmë me një grup fjalësh në shqip.

2. Ti je ende në disketë (pra duke qenë se disketat nuk përdoren më sepse doli në përdorim flashi, cd-ja, dvd-ja, kjo i referohet individit përballë- që pra ti je me të vjetrën).

3. Futi nai fresh – duke qenë se komanda “*refresh*” i jepet kompjuterit kur nuk punon në rregull studentët e përdorin për shokët që t’i thërrasin mendjes.

4. Hidhe në *Recycle bin* – Hidhe në kosh (pra hiqe atë gjë nga mendja) –fshije

5. T’u prish *screen saver*-i (ty nuk të punon truri) duke iu drejtuar shokut

6. Të ka rënë në masë *laptopi* – pra i drejtohen dikujt që nuk është në rregull.

7. E ke mendjen *offline*- s’e ke mendjen – pra nuk ka mendjen të komunikojë me miqtë.

8. E kam *hardisk-un full* – e kam trurin plot

9. Nuk të punon RAM-i (memoria)

10. Formato trurin – në kuptimin që fshije çdo gjë që të ka mbetur

11. Janë bërë copy-paste – si dy komanda të kopjimit në një vend tjetër.

12. Mungesa e apostrofit dhe e shkronjës së madhe vihet re dukshëm (në fillim të fjalisë)

13. Shenjat e pikësimit!

14. Përdorimi i pasthirmave për të dhënë gjendjen emocionale me simbole e figura.

- I qeshuri jepet me hahaha

- Mmm – shije e mirë

- Ups- kur bëhet gabim

15. Shkurtesat në anglisht si ok (në rregull) u-you-ju; bye – mirupafshim

Disa ndikime nga telegrafia celulare

¹¹ Shih I. Angoni, f. 202 V. Memisha, *Pesha e fjalës shqipe*.

¹² *Anketime tek studentët* e Universitetit Eqrem Çabej.

1. Futi *memory card* ose e ka *memory card*-in (karta e memories) për celularët
2. Jam bërë për PUK – pra pasi kanë shtypur tri herë pinin, karta nuk e merr dot PUK – pra e përdorur në kuptimin e çmendur fare.
3. Memory full – memoria plot
4. Më hoqe PIN-in – më çmende fare
5. Një kod sekret i një grupi vajzash mbështetej në mënyrën e të shkruarit të mesazheve në celular. Ato u shprehën se i shkruanin mesazhet sipas shkronjave në tastierën e celularit në bazë të numrave për të dhënë shkronjën përkatëse si p.sh. vëllai ($8^3 2^1 5^3 5^3 2^1 2^1$) në bazë të shtypjes dhe vendin që zënë renditja e shkronjave¹³.

Ky ndikim nga celulari vihet re edhe në përdorimet në internet me kompjuter ku për studentët janë tipike.

Një veçori komunikimi në internet janë përdorimi i shkurtimeve gjatë gjithë bisedës në facebook.

Studentët përdorin terminologjinë e veçantë si simbol të identitetit të tyre dhe si një mënyrë për t'i përjashtuar nga bisedat e tyre individët që nuk i përkasin (si p.sh pedagogët që ata i shohin si armiq të tyre, por edhe prindërit.

Ky zhvillim i kësaj kompetence komunikative tek të rinjtë përbën një shembull domethënës të ndërvarësisë së 2 komunikimeve.

1.-Atij gjuhësor

2. –Jo gjuhësor

Zgjedhja e një forme përshëndetjeje jep tregues të rëndësishëm të marrëdhënieve e raporteve sociale.¹⁴

-Disa veçori të bisedës në facebook.

-Kur përshëndeten i ndajnë përshëndetjet në orare të ndryshme të ditës.

Duke e parë bisedën si një dukuri me shumë kanale ku ka përbërësit e saj- ku marrin pjesë shenja gjuhësore dhe jogjuhësore, sot bisedën e shohim të kryhet virtualisht nëpërmjet internetit. Dje shërbehej me gjeje e mimikë duke shprehur hapur ndjenjat, emocionet, përjetimet e ndryshme këto janë shndërruar në një komunikim me shkrim, ku përveç bisedës si një lloj i veçantë virtual shohim edhe një dukuri të re të shkrimit.

-Në shkëmbimet bisedore duket që ka edhe elemente që nuk duken, por nënkuptohen si rezultat i zotërimit të përbërësve të njohura dhe kodit të përdorur.

-Deri dje përshëndetjet¹⁵ i njihnim nëpërmjet kontaktit, dhënies së dorës ku përdorëshin edhe shprehje gjuhësore për ndërveprim kulturor si pikënisje “Dhënie e dorës” për komunikim.

Sot shërbehet me shkrim në internet me shkurtime¹⁶

- Tungjatjeta –tung

- Të përgëzoj – përgz

¹³ Anketime tek studentët e Universitetit Eqrem Çabej.

¹⁴ Shih Gj. Shkurta, Etnografi e të folurit të shqipes.

¹⁵ Shih më gjerë Gj. Shkurta, Etnografia e të folurit të shqipes.

¹⁶ Anketime tek studentët e Universitetit Eqrem Çabej.

GJURMË TË NDIKIMIT TË MJETEVE TEKNOLOGJIKE NË
KOMUNIKIMIN ME SHKRIM E ME GOJË NËSHQIPEN E SOTME

- Mirëmëngjesi – gjesi(mgjesi)(mrgj)
- Të përshëndes – prsh
- Natën e mirë – ntm
- Të kam xhan – tkxh
- Çfarë po bëni? – Çpb
- Të dua shumë – tdsh
- Kalofshi mirë – klm
- Mirupafshim – pafshim
- Për zotin – pz (betime fetare sipas besimit.
- Kalofsh bukur – klb
- Internet – int
- Facebook – fcb
- Ska për se – sps
- Përgjigje – prgj (pres përgjigje – pprgj)
- Të lutem – tl
- Mesazh – sms
- Nuk e di – nkd
- Përdore! – prd
- Ditë për ditë – dp
- Drejt për drejt – dpd
- Pasdite – psd
- Të kam shpirt – tksh
- Mendoj – mnd
- Qesh – hahaha
- Celular – cel
- Ditën e mirë – dtm
- Jam mërzitur – mrz
- I nxjerr gjuhën - :P (me simbole)
- Buzëqeshje - :)
- Kemi ndonjë gjë? – nd1
- Për – x
 - Si je o file? – Si je, o vëlla?
 - Drekën e mirë – dkm
 - Mirupafshim – paçim (mpfsh)
 - Ndikime nga gjuhë të ndryshme ciao, kalimera, kalinighta
 - Ti kanis, kalla? – si je, mirë?
 - Do të thotë – dtth
 - Telefon – tel
 - Suksese – sks
 - Në qoftë se – nqs
 - Gjithashtu – gjithsh

VALBONA KALEMI

- Gëzohem – gz
- Jam me njerëz – jm1rz
- Shkruaj – shkr
- Shtëpia – shp
- Shkolla – shk
- Natën e mirë – ntm
- Të – t
- Është – é italisht
- Pëlqej – plq
- Megjithatë – mgjth
- Pisi – pc
- Shoqëria – frnd
- Fashion – fsh
- Normale – nrm
- Like – pëlqej
- Shikoj – shk
- Atëherë – ath

Në këto shkurtesa kam vërejtur se studentët shkruajnë

1. Mospërdorimin e shkronjës së madhe atje ku duhet
2. Shenjat e pikësimit pothuajse nuk i përdorin
3. Kur në një fjalë 2 bashkëtingëllore që ndjekin njëra-tjetrën ata nuk i ndajnë si p.sh. (rz, nd, rd, sd,) s'i shkruaj
4. Zëvendësimi i s me c. – *pisi* – *pc* dhe i k me c tek komentoj – comentoj
5. Përdorimi i (të) së formës së mënyrës lidhore nuk përdoret.
6. Përdorimi i simboleve (kur mërzhiten, kur qeshin) pra futja e simboleve
7. Futja e numrave si tek (njerëzit) përdorim i 1 ose te fjala (ndonjë1)
8. Tek fjalët shumëroreshe studentët përdorin 2 rrokjet e para
9. Përdorimi i apostrofit mungon.
10. Ka fjalë që shkruajnë 2 rrokjet fundore kur është fjala 4 rrokëshe.

Një bisedë mes 2 të rinjve që pëlqenin njeri-tjetrin Jorela dhe Ervini në facebook.
(e shkurtër)

Përshendetje – Prsh

Zemra – zmr

Si kalove sot? Sks

Bukur – bk

Ç'kemi ndonjë gjë të re? – Ç k n d r

Asgjë – asgj

Si zakonisht – szk

Si do t'ia bëjmë të dalim sot? Sdtbtdst

Nuk e di – nd

E kam pak të vështirë – ekp të vësh

GJURMË TË NDIKIMIT TË MJETEVE TEKNOLOGJIKE NË
KOMUNIKIMIN ME SHKRIM E ME GOJË NËSHQIPEN E SOTME

Pse? – ps

Sepse kam prindërit – spk pr

Mund t’u them që kam ditëlindjen e një shoqeje? – Mt thm qkm ditl 1 shq

Mirë – mr

Shihemi më vonë! – shmv

Ciao – ciao – përshëndeten

Pra gjithë biseda e të rinjve zhvillohet me shkurtesa dhe pa një shenjë pikësimi.

Duke e parë shqetësimin jo të vogël përse i përket mënyrës se si të rinjtë e përdorin mjetin teknologjik, duke u bërë madje edhe një fushë e re hulumtimesh shohim përditë dëmin që i shkaktohet gjuhës standarde.

“Norma” duhet parë si një tërësi mjeteesh të qëndrueshme që kanë edhe hapësirat e caktuara të marrëdhënieve me jo normën që ndeshja e dy formave gjuhësore shpesh bëhet shkak për lakminë që ka pra forma jo standarde e shtrin ndikimin mbi atë standarde.

Kjo prirje është tepër e rrezikshme sidomos edhe në rastin tonë drejtshkrimit të shqipes.

-Shpesh në rrethet e gjuhëtarëve është dënuar prirja vesëkeqe e përdorimit të gjuhës në media prej folësve e shkruarve që shihem me rrezik për audiencën shqipfolëse.

Për t’u parë vlen të bëjmë një punë të madhe edhe për situatën që kanë krijuar të rinjtë prirjen e ashtuquajtur “trendy” prej të rinjve sot për deformimin që i bëjnë ato gjuhës në komunikimin me gojë por edhe me shkrim.

-Interesimi dhe kujdesi i vazhdueshëm për zhvillimin e gjuhës sonë amtare për ruajtjen e pastërtisë e të origjinalitetit të saj ka qenë karakteristikë e përbashkët e figurave të shquara të kulturës sonë kombëtare.

E duke parë këtë keqpërdorim të gjuhës në të shkruar për shpejtësi kumtuese që duket se i shërben brezit të ri, por si një “vrasëse e gjuhës” së bukur e standarde shqipe nesër, e përmbyll këtë studim jo në këtë fazë kërkimore por edhe më tej me pararendësit e sociolinguistikës shqiptare, i madhi at Justin Rrota që në konceptin e tij “kush thërret përparim të çoroditurit e trajtave, gjymtimet e elementëve përbërëse të gjuhës, të pështjelluemet e natyrës së fjalvet, nuk asht më të”¹⁷.

¹⁷ Shih J. Rrota, *Gjuha shkon tue bam ato ndryshimet e veta*, Hylli i Dritës 1931, f. 132.